



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 158/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha, dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Klinë, paraqitur kundër Drejtorisë për Shërbime Komunale në Klinë, për shkak të vendosjes së tendës në rrugë publike, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Hidhet e palejuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR)
Arsyetim

PZAP-i me datën 04. 06.2014, ka pranuar një ankesë nga subjekti AKR me të cilën pretendohet se Drejtoria e Shërbimeve Publike, në mënyrë jo ligjore e ka refuzuar kërkesën për vendosjen e tendës në qytet për zhvillimin e fushatës zgjedhore pavarësisht faktit se faktit se në pajtim me ligjin dhe me kohë kanë qenë të njoftuar KKZ-ja Parashtruesi i ankesës thekson se kjo penges e qeverisë komunale në Klinë është tendencioze dhe e qëllimshme .

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës gjeti se :

ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstaton se pretendimet ankimore ndaj drejtorisë publike të shërbimeve komunale në Komunën e Klinës, janë të palejuar që të paraqiten në PZAP, sepse PZAP-i është institucion që vendos për vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) sipas nenit 122 par.1 pikat a, b, c, d, e dhe f, meqenëse në asnjërin nga pikat e lartëpërmenduar të dispozitivës nuk kanë rënë pretendimet e parashtruar në ankesë, PZAP-i vendosi si në dispozitivë të këtij vendimi duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 158/2014 më datën 06.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*